

URDHËR
Nr. 162, datë 12.4.2021

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E OHRIT, PRESPËS, FIERZËS,
ULZËS DHE SHKOPETIT**

(Ndryshuar me urdhërin nr. 166, datë 20.4.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdoj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit dhe, konkretisht:

- Për gjuhçën (cironka), prej 20 prillit deri më 20 korrik 2021, në liqenin e Ohrit, dhe prej 1 prillit deri më 31 korrik 2021, për liqenin e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

- Për krapin, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2021, në liqenin e Ohrit, dhe prej 25 prillit deri më 25 maj 2021, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.

2. Për periudhën 20.7.2021 deri më 20.8.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore, prej 300 ml nga bregu, për liqenin e Ohrit dhe për periudhën 25.4.2021 deri më 25.6.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore, prej 150 ml nga bregu, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitetet peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në vartësi të së cilës është Sektori i Kontrollit të Peshkimit, Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, që të monitorojnë zbatimin e planit operativ të veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Milva Ekonomi